



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.54/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP), për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,500.00 (njëmijë e pesqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën kryesore përgjat lumit në Prizren monitoruesit e tyre kanë hasur në postere të kandidatit për deputet nga subjektit politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP) të ngjitur në drunj të qytetit gjegjësisht në hapsirë publike. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara dhe CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, subjekti politik KDTP njoftoi se të gjitha posterat në fjalë janë larguar nga vendi ku kanë qenë të vendosura, ku për këtë si dëshmi ka bashkangjitur forografit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik KDTP janë vendosur në drunj gjegjësisht në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila

përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike”

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik KDTP është shkëlur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik KDTP, janë të vendosur në rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik KDTP, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posterat e kandidatëve për deputet nga ky subjekt politik janë vendosur në drunjë gjegjësisht në rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmasimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.54/2017 më datën 06.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.